



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Nji-ks.org Org.Jedinita Org.Unit	<i>ARPL</i>	Nr.i Prot. Broj Prot. Prot.No	<i>123-2/23</i>
Nr.i Faqesve Br. Stranica No.Pages	<i>-03-</i>	Datsh Datum Date	<i>02.02.23</i>
PRISHTINË / A			No.1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore / Regional River Basin Authority / Regionalni
Autoritet Rijecni Slivova

DATË/A:	15.02.2024
REFERENC-Ë:	123/23 - ARPL - /2024
PËR/ZA/TO:	Veton Rrmoku , Rr.Llapit Nr.232, Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së Z. Naser HAFIZI, Zëvendësues i drejtorit të ARPL-së
NGA/OD/FROM:	Mevlane AJVAZI- Zyrtare për Planifikim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	VENDIM

Sipas kërkesës tuaj me, Nr. Prot. 123/23, organi kompetent i MMPH-së ka shqyrtuar dokumentacionin e dorëzuar, lidhur me kërkesën për marrjen në shfrytëzim të hapsirës publike , parcela kadastrale 7773-1, sipas Çertifikatës së pronës P-719914059-07717-1 e quajtur Pasuri Shoqërore Ujërat , Prishtinë .

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Opsteg Sekretara/Office of the General Secretary

Bazuar në nenin 71 të Ligjit Për Ujërat e Kosovës (Nr. 04/L-147), nenin 27 dhe nenin 44 të Ligjit Nr. 05/L-03, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, bazuar në kërkesën e palës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor pas shqyrtimit të kërkesës ka nxjerrë këtë:

V E N D I M

NUK APROVOHET kërkesa e palës për dhënje të pëlqimit për parcelën kadastrale 7773-1, sipas Çertifikatës së pronës P-719914059-07717-1 vendi i quajtur Pasuri Shoqërore Ujërat në Prishtinë .

Arsyetim

Pala Veton Rrmoku ka aplikuar me kërkesë me nr.protokol. 123/23 për dhënje të pëlqimit për parcelën kadastrale 7773-1, sipas Certifikatës së pronës P-719914059-07717 , Pasuri Shoqërore Ujërat , Prishtinë .

Pala kërkesës i ka bashkangjitur :

- Formulari I kerkeses ;
- Kopja e lejes së njoftimit për Veton Rrmoku ;
- Vendim nga Komuna e Prishtinës .
- Kontrate mbi blerjen e perkoheshme te tokësse ndertimtarise .
- Fatur nga Komuna e Prishtinës.
- Skicë tereni.
- Procesverbali nga tereni- Njësia kadastrale 7717-7.
- Çertifikata e regjistrimit te biznesit Geo- Consulting SH.P.K.
- Licencë për Kompanine e Licencuar Gjeodete “GEO- Consulting “ SH.P.K.

Faqe 2 nga 3



Në kuadër të shqyrtimit të dokumentacionit është konstatuar se Njësia kadastrale nr.P-719914059-07717, Pronë shoqërore Ujërat , Prishtinë i cili ka kërkuar ne shfrytëzim pala Veton Rrmoku në bazë të nenit 109, Ligji Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës është nën administrimin e Ministris së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI-se). Gjithashtu, është konstatuar se ende nuk është arritur bartja dhe regjistrimi i pronave i përcaktuar sipas dispozitës ligjore me paragrafin 3 të nenin 110, Ligji Nr 04/L-147, për Ujërat e Kosovës, e cila është e domosdoshme për administrimin e shfrytëzimit të pronave;

Bazuar në karakterin e kërkesës me nr.prot 123/23 date : 11.01.2023 për shfrytëzim afatgjatë të sipërfaqes së pronës dhe deri në përfundimin e hartimit të Planit Menaxhues të Pellgut përkatës lumor i cili është bazë ligjore e menaxhimit afatgjatë të pronave ujore, është konstatuar se gjendja faktike administrativo ligjore pamundëson bazën ligjore të dhënjës së pronës konkrete në shfrytëzim.

Bazuar në konstatimet e theksuara në paragrafet paraprak, kërkesës së palës për të shfrytëzuar këtë pronë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE :

Pala e pakënaqur ka të drejtë në inicimin e procedurës së Kontestit Administrativ në Gjykatën kompetente të Kosovës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Nr: 123/23 - ARPL- Datë: 15.02.2024
Prishtinë

T'i dërgohet :

1. Palës,
2. K. Prishtinës
3. Inspektoratit,
4. ARPL-së
5. Arkivit të MMPH-së.

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së



Faqe 3 nga 3